



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 66**

Datë: 29. 11. 2017, ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.65/2017;*

2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare për Kuvendin Komunal 2017

3. Shpallja e Rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kryetar Komune të Raundit të dytë

4. Të ndryshme;

---

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.65/2017;*

**Valdete Daka:** Po fillojmë mbledhjen numër 66 të KQZ-së. pikat e rendit të ditës janë këto: shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit të mbledhjes së kaluar, shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për kryetarë të komunave të raundit të dytë, si dhe certifikimi I rezultateve përfundimtare për kuvende komunale. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite? Nëse jo, kush është për?

*Anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës.*

**Valdete Daka:** Shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet për të gjitha komunat, përveç për komunat e Istogut dhe Kllokotit, ndërsa për kuvend komunal përveç për komunën e Vushtrrisë.

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.65/2017*

**Valdete Daka:** A ka dikush vërejtje në procesverbal? Nëse jo, kush është për? Anëtarët e KQZ miratuan procesverbalin e mbledhjes numër 65/2017

## **2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare për Kuvendin Komunal 2017**

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me shpalljen e rezultateve përfundimtare për kryetarë të Komunave në Raundin e Dytë. Komuna e Gjakovës, Ardian Gjini nga AAK ka marrë 21 999 vota apo 53,46%, kurse Mimoza Kusari-Lila nga ALTERNATIVA ka 19 152 vota apo 46.54. Komuna e Gjilanit- Lutfi Haziri nga LDK ka 21 261 vota po 63.815 DHE Sami Kurteshi nga LVV ka 12 057 apo 36.19%.

**Betim Gjoshi:** Kryetare, a i miratojmë një nga një komunat ?

**Valdete Daka:** Po, mundemi. Kush është për këtë rezultat në Gjakovë ?

**Adnan Rrustemi:** Është hera e parë që i miratojmë një nga një. Nuk është në rregull rezultatet janë të procesuara në përputhje me procedurat nga QNR, kushdo që ka me thanë diçka le të thotë, por ne duhet me i miratuar në fund.

**Valdete Daka:** Për komunën e Gjilanit kush është për? Dragash- Shaban Shabani nga PDK ka 6579 vota apo 51.07% si dhe Selim Kryeziu nga LDK ka 6 303 apo 48.93%. Kush është për këtë rezultat? Faleminderit. Vazhdojmë me komunën e Kaçanikut, Besim Ilazi nga PDK 6782 vota apo 54.73% si dhe Basri Kajtazi nga LVV 5609 vota apo 45.27%. Kush është për? Faleminderit. Komuna e Klinës, Zenun Elezaj nga AAK ka 8397 vota apo 51.62% dhe Sokol Bashotanga PDK ka 7869 vota apo 48.38%. Kush është për? Faleminderit. Komuna e Kamenicë, Qëndron Kastrati nga LVV ka 8764 vota apo 55.57% dhe Shahip Surdulli nga LDK ka 7006 vota apo 44.43%. Kush është për? Faleminderit. Mitrovicë, Agim Bahtiri nga AKR ka 16509 vota apo 57.41 dhe Valdete Idrizi nga PKD 12245 vota apo 42.59%. Kush është për ? Faleminderit. Komuna e Obiliqit, Xhafer Gashi nga AAK ka 6730 vota apo 60.52% dhe Mehmet Krasniqi nga LDK ka 4152 vota apo 39.48%. Kush është për? Faleminderit. Komuna e Rahovecit, Smajl Latifi nga AAK ka 10561 vota apo 50.70% dhe Idriz Vehapi nga PDK ka 10271 vota apo 49.30%.

**Betim Gjoshi:** Për shkak të disa shqetësimeve që janë paraqitur rreth komunës së Rahovecit edhe duke u bazuar që një pjesë e vërejtjeve në ditën e zgjedhjeve, nuk janë adresuar. Unë do të votoj kundër komunës së Rahovecit.

**Adnan Rrustemi:** Mendoj që në fillim e ngatërruam procedurën. E para nuk votuam për propozimin që u dha, a mu votuar komunë për komunë apo në tërësi. Ne jemi institucion pavarësisht para pëlqimit politik, ky është një akt institucional që ne duhet ti shpallim rezultatet komunë për komunë. Nuk mundemi me ja nënshtruar votës këtë shpalljen e rezultateve, madje edhe me hap procedurë për çfarëdo adresimi apo kërkesë. Në një rast si kjo ku nuk miratohet Rahoveci çka ndodh? Është punë akti që duhet të miratohet me dy të tretat, ma jep një përgjigje për një komunë që nuk miratohet. Problemi, është që nuk duhet të miratohet komunë për komunë, duhet me marr vendim institucional, ne jemi duke shpall rezultatet përfundimtare për zgjedhjet lokale. Nuk i kemi miratuar asnjëherë kështu. Ne, i kemi një palë zgjedhje në të njëjtën datë me të njëjtat vendime me të njëjtat përgatitje, na ose duhet me të njëjtat përgatitje, na ose duhet mi miratuar dhe shpall rezultatet përfundimtare të gjitha komunat që i kanë kapërcyer procedurat e rregullta në QNR ose duhet me ndërpre procesin. Nuk mundemi tash KQZ-në ta bëjmë institucion të arazhimit politike, atëherë hedhe propozimin për tu miratuar shpallja e rezultateve një nga një. Atëherë është në kundërshtim me rendin e ditës, nuk është miratuar.

**Betim Gjoshi:** Ne, mundemi mi shpreh shqetësimet tona, por nuk mundemi me ja imponuar njëri tjetrit mendimet tona. Komunat i kemi miratuar në zona të veçanta zgjedhore ligji, kushtetuta parasheh një nga një gjitha veçmas. Unë jam të paktën prej 2009 në zgjedhje lokale i kemi miratuar, certifikuar një nga një për arsye se nuk janë zgjedhje nacionale. Është formalitet edhe procedurë të cilën ne e kryejmë sot edhe për të cilën jemi duke proceduar dhe besoj se nuk kemi nevojë me u hidhëruar. Ne, i votuam i miratuar disa komuna, vazhdojmë tutje me procedurat. Nuk e ditëm fatin e Rahovecit, a u miratua apo jo, shpreha qëndrimin tim edhe arsyeje pse po votoj kështu që është me vazhduar më tutje

**Binak Vishi:** Për shkak se është kandidati i Aleancës fitues, unë e respektoj votën e secilit anëtar të KQZ-së. Për mua janë dy praktikat edhe për ti votuar të gjitha edhe një nga një sepse rezultati është aty fitues të tjerë nuk mundemi me shpall pos ata që i ka shpallur qytetari i Kosovës, për cilën do formë unë jam i gatshëm. Filluam kështu vazhdojmë kështu se nuk ka shqetësim edhe pse nuk e votojnë Rahovecin dikush, unë mendoj që duhen dy të tretat, 8 vota nevojiten.

**Adnan Rrustemi:** Ne, jemi institucion kushtetues, profesional pavarësisht origjinës sonë politike. Ne i kemi procedurat tona ligjin, rregullat dhe kur ne konsiderojmë që procedurat i kemi përmbyllur ne nuk mundemi me bllokuar politikisht shpalljen e rezultateve.

**Valdete Daka:** Kush është për rezultatet e komunës së Rahovecit?

Anëtarëte e KQZ miratuan rezultatet e kësaj komune me 9 për, dhe 2 kundër (Betim Gjoshi dhe Ilir Gashi)

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me komunën e Podujevës

Agim Veliu nga LDK ka 20027 vota apo 63.78%, Ajet Potera nga LVV 11373 vota apo 36.22%. Kush është për? Faleminderit. Vazhdojmë me Prishtinën, Shpend Ahmeti nga LVV ka 42262 vota apo 50.22% ndërkaq Arban Abrashi nga LDK ka 41897 vota apo 49.78%. Kush është për?

**Sami Hamiti:** Normalisht që LDK-ja ka shkuar në PZAP ka dërguar një ankesë më herët për çështjen e rinumërimit të disa ankesave që i ka pasur nga vendvotimet edhe mos barazimet që kanë qenë. Normalisht ne e kemi marr një vendim në KQZ për rinumërim, nuk e di qysh nuk e kemi anuluar atë vendim të rinumërimit të menjëhershëm por kemi pritur pas trysnive që kanë ardhur shumë të mëdha që ajo të ndërpritet prej Gjykatës Supreme, është vendosur një standard i ri, në rregull sepse është punuar me standarde të dyfishta dhe është vazhduar me rinumërimin e votave me kusht dhe me post që ka qenë kërkes e LVV nga fillimi. Realisht gjatë numërimit të votave me kusht doli që LVV ka bërë një trysni shumë të madhe që të bëhet numërimi i këtyre votave me kusht para se të bëhet numërimi në tërësi i kutive në Prishtinë dhe me një shqetësim shumë të madh kanë bërë trysni që të merret ai vendim nga Gjykata Supreme. Çka ka ndodhur?

Konfirmimi, tha z. Hamiti është se nga votat me kusht, tri zarfe të fshehtësisë janë të zbrazëta, kjo është konstatim sepse ka ndodhur atë ditë, d.m.th tri zarfe të votave me kusht të cilat janë konfirmuar dalin që janë të zbrazëta që automatikisht ta jep orientimin që ka ndodh treni bullgar në Prishtinë. Pse LDK-ja nuk e ka pasur problem të shikohen ato? Sepse nuk ka bërë asgjë që të bënte trysni të mos numërohen ato. Ne e dimë që në çdo vendvotim sot KQZ-ja me vendim, sekretariati propozimin KQZ-ja e ka vulën e vet. Unë mendoj që problemet që janë sjellë edhe angazhimi ka qenë shumë i madh që mos të bëhet rinumërimi ka qenë sepse diçka ka ndodhur në kuti. Problemi tjetër është pse nuk është dashur të bëhet ai rinumërim, po flasim në shtete demokrate është 1% diferenca edhe në Amerikë e keni parë edhe në Floridë është bërë rinumërimi për 1%, nuk e paskemi qitur në ligj dhe nuk është bërë, prandaj unë mendoj që shqetësimet që i ka pasur LDK-ja janë konfirmuar pas kësaj. Kështu që unë nuk do të votoj për Prishtinën.

**Adnan Rrustemi:** Është shqetësuese, unë po drejtohem kryetare si përgjegjës i institucionit që po lejohet me u përdorë institucioni madje për ti realizuar qëllimet që tashmë Gjykata Supreme i ka zhvlerësuar, ne e dimë që anëtarët e KQZ-së që shpallja e rezultateve përfundimtare, nëse jo për tjetër për të ja hapur

rrugën palëve që kanë parashtruar ankesa, duhet me ndodh. Nuk mund të përdoret shpallja e rezultateve përfundimtare si mekanizëm për me bllokuar. Këto janë të pa qëndrueshme që i tha z. Hamiti pa asnjë dyshim, janë komplet inskenime për ta arsyetuar gjendjen. Zarfet me kush askush nuk e di çfarë ka në zarfin e fshehtësisë të zarfit me kusht, përveç komisionerët dhe gjitha subjektet politike e në rastin e Prishtinës subjektet partnere me LDK-në. Votuesit i përket me fut fletëvotimin në zarfin e fshehtësisë e zarfin e fshehtësisë bashkë me kryesuesin me zarfin me të dhëna personale. Nuk është hera e parë që në KQZ dhe këtu mundet me na konfirmuar edhe koordinatori i QNR-së, në secilën komunë po thuajse has zarfe të votimit me kusht ku nuk ndodhet fletëvotimi, kjo ndodh nga arsyet nga më të ndryshmet, nga ajo se votuesit mund ta harrojnë në tavolinën e kryesuesit, nga ajo që ka mund ta marr me veti. Edhe për fenomenin bullgar në komunat e tjera e në procese të kaluara. Është proteks i pa qëndrueshëm. Kush ka ankesa le te përdorë afatin 24 orë pa u shpall ankesa, por jo me ngrit spekulime në raport me aktin e shpalljeve të rezultateve përfundimtare.

**Sami Hamiti:** Ju keni qenë kategorikisht që mos të bëhet rinumërimi, sepse keni pasur këtë dyshim sepse thjesht keni funksionuar me trenin bullgar, për ndryshe nuk keni pasur arsye mos me konsistuar sepse ai rezultat kishte ardhur. Por e keni ditur shumë mirë që vulat e votimeve dhe kur hapen dhe shikohen, gjenden fletëvotime të një vendvotimi tjetër të bartura sepse merr askush për dashuri fletëvotimin me veti.

**Adnan Rrustemi:** Është qesharake dhe nuk e beson as vet për fenomen të trenit bullgar në një situatë ku e kanë kontrolluar komplet këshillin e vendvotimit e kanë pasur vetëm një komisioner madje as vet AKR-ja nuk ka pasur komisioner në të gjitha vendvotimet. Kjo çështje është komplet politike që po përdoret në KQZ sot në aktin e shpalljeve të rezultateve përfundimtare. Kush do që ka ankesa le të bëjë ankesa.

**Valdete Daka:** Kush është për rezultatin e Prishtinës? Faleminderit. Kush është kundër? Faleminderit. Vazhdojmë me Prizrenin, Mytahir Haskukaj nga LVV 25449 vota apo 50.36%, Shaqir Totajt nga PDK ka 25577 vota apo 49.64%.

**Betim Gjoshi:** Unë si anëtar i KQZ-së, do të votoj kundër rezultateve të Prizrenit pasi i kam dyshimet e mia. Dita e ditës dyshimet e mia po shtohen mendoj që këto rezultate nuk pasqyrojnë vullnetin real të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Se nuk kishte proces të rregullt në Prizren, janë të shumta argumentet të cilat shkojnë, e para është tendenca e cila me çdo kusht dhe me çdo lloj mjeti nuk lejohet transparenca e hapjeve të kutive të votimit, numërimi dhe hetimi i fletëvotimeve që ndodhi ku institucioni edhe si i joni ra pre e presionit. Gjithashtu ishte edhe gjatë procesit të numërimit të votave me kusht, ku isha dëshmitar edhe vet ishin mediat edhe të tjerët. U pa që tri fletëvotime, kjo vërtetohet edhe ne procesverbalet e QNR-së, ku tri fletëvotime mungojnë dhe nuk janë brenda zarfit që do të thotë që ato fletëvotime nuk e dimë se ku kanë ndodhur. Kjo na ka bërë me pas dyshime të bazuara që është aplikuar i ashtuquajturit treni bullgar, ku nxjerr fletëvotime origjinale nga vendvotimi edhe ku ka mundur të keqpërdoret me qindra herë. Edhe kur shihet tendenca ku mos mu pa kjo bëhet më e argumentuar. Kjo që po flas është e argumentuar edhe me formularët e publikuar në ueb-faqen e KQZ-së, formularin CB004, mungojnë dy fletëvotime. Mandej është e evidentuar në rubrikën e 10 të këtij formulari, mandej në formularin CB12001 ku mungon një fletëvotim në rubrikën 10 ku evidentohet mungesa e fletëvotimit. Shtrohet pyetja ku ndodhen këto fletëvotime? Dhe përse përdoren, dyshimet i përforcon më shumë edhe manipulimi i votave me post ku

nga votat e ardhura me post 100% ishin për një kandidat, kjo e bën edhe më dyshuese procesin. Mandej edhe trendi i votave me kusht për cilin kanë pasur vështirë ta ndryshojnë, është i kundërt dhe nxjerr një rezultat krejt tjetër për njërin kandidat. Këto janë shqetësimet që i kemi pasur gjatë ditëve që i kanë paraqitur subjektet politike përmes ankesave. Mua më bën si anëtar i KQZ-së që mos të kem siguri për të votuar për këtë rezultat, prandaj do të votoj kundër. Kështu që kjo i hap rrugë subjekteve politike që ta ankimojnë këtë rezultat nga organet kompetente, ashtu siç e parasheh ligji.

**Adnan Rustemi:** Si institucion po i referohem mbledhjes së fundit qështë e vërteta ku me plot gojë I referoheshit obligimeve të obligueshme për KQZ-ën madje edhe në kundërshtim me dispozitën për mjete juridike dhe për 24 orë-shin për ankesë, në ndërkohë për shumë më pak ditë kalojmë nga një pozicion që kërkojmë dhe insistojmë që vendimet e institucioneve me u zbatuar në një pozicion kur vendimi i gjykatës Supreme refuzohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve respektivisht nga anëtarët e caktuar. Nuk bëhet fjalë, ne të gjithë e dimë këtu si anëtarë të KQZ-ës se në cilat situata ndodh rinumërimi nuk ka asgjë për tu fshehur në fakt madje as rinumërimi nuk është synim i juaji duhet të jemi të saktë. Nuk bëhet fjalë për fletëvotime të votave me kusht, ngase kjo është mbledhje unë kam pyetje për koordinatorin e QNR-ës le të më përgjigjet se në sa komuna ka hasur në raste të tilla dhe në zarfet me fletëvotimet me kusht ka munguar së paku një fletëvotim. A bëhet fjalë veç për Prizrenin dhe Prishtinën siç po shihen edhe qëndrimet e sinkronizuara midis përfaqësuesve të LDK-ës dhe PDK-ës.

Përgjigjja është e qartë në secilën komunë, tha z. Rustemi dhe se, jam i bindur që në komunat tjera keni me has numër edhe shumë më të madh të shpërpushjeve midis mungesës së zarfeve në fletëvotimin e zarfeve me kusht ashtu siç ndodh edhe në vendvotimet e rregullta kur mund të kemi mungesë dhe shpërpushje midis nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve dhe numrit të fletëvotimeve në kuti madje e kemi të përcaktuar edhe me ligj e me rregull këtë punë se kufirin e tolerancës së në çfarë masa mund të ndodh që votuesi mos ta ketë hedhur fletëvotimin 1 deri 100 vota plus minus madje deri 100 deri në 2 fletëvotime. Mbi 200 deri në 3 fletëvotime këto janë procedura të rregullta të KQZ-ës të miratuara nga KQZ-ës asnjë nga këto nuk qëndron janë thjeshtë argumente politike madje leximet e qëndrimeve politike për të krijuar opinionin në raport me çështjet e ngritura të pabazuara, nuk ka asnjë parregullsi vet e dini i keni pas komisionarët nuk ka evidentu asnjë parregullsi QNR-ja, është rasti i parë mbasi në këto 2 komuna nuk ka rekomanduar asnjë vendim në rastin e dytë për vendim në KQZ-ës ose për rritje të kufijve të tolerancës. Madje në raundin e parë kemi pasur kësi raste kur QNR ka kërkuar në KQZ-ë me marr me rrit kufirin e tolerancës plus minus 6 fletëvotime ose 6 nënshkrime të votuesve. Nuk ka pas asnjë rast që ka mbërri deri në 3 që ka mbërri deri në Prishtinë e në Prizren referojuni dokumenteve të QNR-ës të organeve tona le ti sjell raportet mos të lexojnë dokumente selektive veç sa për me krijuar opinion d.m.th. nuk është e vërtetë ajo ka pasur jam i bindur që në çdo komunë, dhe po kërkoj konfirmim prej Burimit, a bëhet fjalë që vetëm për Prizrenin dhe Prishtinën që kinse kanë munguar fletëvotimet në zarfet e votimit me kusht? Sa i përket fletëvotimeve me postë, mu me vjen keq, që një kandidat për kryetar komune mos me pas dike nga mërgata që e voton. Ne si institucion është dashur të shqetësohemi pse kemi pasur kaq pak votues nga diaspora. Me kriju mundësi ma shumë, me shpërnda informata.

**Illir Gashi:** Para çdo vendimi mendoj që duhet t'i paraprijë një arsye. E tha edhe kolegu, në mbledhjen e kaluar kemi thënë që do t'i respektojmë vendimet që do t'i merr gjykata supreme, por vota është e jona këtu dhe ne nga ajo që kemi pa, fatkeqësisht del që "të gjitha rrugët qojnë në Romë". Ditën e diele dikush i ka hypë trenit, sepse mungesa e fletëvotimeve të cilat nuk po mundte me i gjetë askush është dëshmi që dikush e ka përdorur trenin bullgar mu më ka shqetësuar fakti atë ditë, që gatishmëria e një subjekti

politik edhe me ndezë luftë vetëm mos me u hapë kutit. Kjo dëshmon se ata e dinë çka ka në ato kutia. Shantazhet publike që janë bërë këto ditë, edhe kundër gjyqësorit, jam i bindur që edhe ato vendimet janë të ardhura nga shantazhet dhe kërcënimet. Madje kanë kërcënuar edhe njerëz që kanë bërë ankesa në Prizren. Unë nuk mundet me votuar pro, për faktin se është cenuar e drejta për me pas një transparencë të madhe karshi opinionit publik.

**Betim Gjoshi:** Nuk mundemi me fyerje dhe zhurmë me mbuluar atë që ka ndodhë ditën e zgjedhjeve. Raundi i dytë në Kosovë ka qenë më i tensionuar dhe ka pasur tendenca me manipuluar. Mund ta krahasojmë raundin e parë dhe të dytë. Patëm rinumërim në dy komuna dhe e vërtetoj gjendjen reale. Nuk pat prej askujt as kërcënime as zhurmë. Me të njëjtat argumente janë rinumëruar edhe ato dy-at. Është legjitimuar fituesi. Ka mundur të ndodhë e njëjta po të ishte korrekt.

**Adnan Rustemi:** Nuk mund të ketë rinumërim për të ia plotësuar dëshirat kandidatëve.

**Valdete Daka:** Kush është për këtë rezultat? Kush është kundër? Vazhdojmë me komunën e Shtimes. Naim Ismajli nga PDK ka 6 552 vota apo 51.61% dhe fatmir Rashiti, kandidat i pavarur, ka 5861 vota apo 48.39%. Kush është për? Vazhdojmë me Suhareken. Bali Muharremaj nga AAK ka 13 755 vota apo 52.57% dhe Sali Asllanaj nga LDK ka 12 401 vota apo 47.43%. Kush është për? Faleminderit! Komuna e Ferizajt. Agim Aliu nga PDK ka 24 384 vota apo 56.18% dhe Muharrem Sfarqa nga LDK ka 19 016 vota apo 43.82%. Kush është për? Komuna e Vushtrrisë. Xhafer Tahiri nga LDK ka 15 122 vota apo 54.24% dhe Ferid Idrizi nga PDK ka 12 758 vota apo 45.76%. Kush është për? Komuna e Malishevës, Ragipbegaj nga Nisma për Kosovën ka 10 868 vota apo 55.80% dhe Mursel Gashi nga PDK ka 8 607 vota apo 44.20%. Kush është për? Komuna e Parteshit, Dragan Petkociq nga Lista serbe ka 1 331 vota apo 61.94%, kurse Nenad Cetkovic nga inisjativanaronaslloga ka 818 vota apo 38.06%. Kush është për? Vazhdojmë më rezultatet përfundimtare për komuna. Komuna e Deqanit, AAK ka 1119 vota apo 59.68% dhe 17 asambleistë, LDK ka 2717 vota apo 17.78% apo 5 asambleistë, PDK ka 1 606 vota apo 10.51% dhe 3 asambleistë, VV 1378 vota apo 9.02% dhe 2 asambleist, AKR 250 vota apo 1.64% s`ka ulëse, Nisma 153 vota, s`ka ulëse, dhe Balli Kombëtar i Kosovës ka 56 vota apo 0.37% dhe s`ka ulëse. Kush është për? Komuna e Gjakovës, AAK ka 10 148 vota apo 25.19%

**Betim Gjoshi:** Nëse doni me thjeshtuar punë, unë vetëm për komunën e Istogut do të abstenoj, për të tjerat duhet vetëm shumicë e thjeshte dhe mundemi me i votuar komplet.

**Valdete Daka:** Vetëm Vushtrria mungon. Nëse jeni të pajtimit. Kush është për certifikimin e rezultateve për të gjitha komunat përveç për komunën e Vushtrrisë dhe Istogun e votojmë ndaras. Kush është për certifikimin e rezultateve në komunën e Istogut? Nga ora 15:00 fillon të rrjedhë afati për ankesa.

**Për KOZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----